




UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
FAKULTETI I INXHINIERISË MEKANIKE

Bregu i Diellit, 10 000 Prishtine, Republika e Kosoves
Tel: +381 38 552 126 ext.101 • E-mail: fim@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Nr. Prot.: 14

Data: 4 / 1 / 2018

RREGULLORE PUNE
INSTITUTI I INXHINIERISË MEKANIKE



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
FAKULTETI I INXHINIERISË MEKANIKE

Bregu i Diellit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381 38 552 126 ext.101 • E-mail: fim@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Nr. Prot.: 14
Datë: 4 / 1 / 2018

Në bazë të kompetencave të përcaktuara sipas nenit 13, paragrafit 1, alinesë 1.14, nenit 65, paragrafit 3 të Statutit të Universitetit të Prishtinës "HASAN PRISHTINA" dhe nenit 9 të Rregullores për themelimin dhe parimet e funksionimit të Instituteve në Universitetit të Prishtinës "HASAN PRISHTINA", Këshilli Drejtues në mbledhjen e mbajtur me datën 29.12.2017, miratoi

RREGULLOREN
e punës së Institutit të Inxhinierisë Mekanike

Neni 1

Në kuadër të Institutit të Inxhinierisë Mekanike, personeli akademik i Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike (FIM) dhe ekspertët e jashtëm, mund të merren me punë shkencore, hulumtuese dhe profesionale.

Neni 2

Veprimtaritë themelore - Njësitë e Institutit të Inxhinierisë Mekanike janë:

- 2.1 Atestimin dhe dhënia e certifikatave për automjete dhe makina punuese (si institucion i vetëm i autorizuar në Republikën e Kosovës).
- 2.2 Lëshimi i certifikatave, atesteve dhe ekspertizave.
- 2.3 Kryerjen e super ekspertizave gjyqësore për sigurinë në punë,
- 2.4 Laboratori për kalibrimin e pajisjeve për kontrollimin teknik të automjeteve.
- 2.5 Laboratori për kontrollim teknik të automjeteve.
- 2.6 Laboratori për hulumtim të përshtatshmërisë dhe ndryshimeve në automjete - Homologimi i automjeteve motorike.
- 2.7 Shtypja e numrit të shasisë (VIN shenja) dhe verifikimi i numrit përkatës,
- 2.8 Hartimi i projekteve shkencore dhe profesionale nga lëmia e Inxhinierisë Prodhuese, Termoenergjitikës, Termoteknikës, Konstruktimit me Mekanizim, Komunikacionit, Mekatronikës, Inxhinieria Industriale dhe Menaxhmentit si dhe Sistemet e Energjisë së Ripërtëritëshme,
- 2.9 Zbatimi i të arriturave shkencore në praktikë,
- 2.10 Mbikëqyrja e punimeve sipas projekteve të lartpërmendura,
- 2.11 Kryerja e recensioneve dhe e revizioneve të punimeve shkencore, profesionale dhe projekteve,
- 2.12 Pranimi i objekteve të realizuara,
- 2.13 Analiza profesionale për pajisjet dhe makinat nga aspekti i mbrojtjes në punë,
- 2.14 Aftësimi dhe dhënia e certifikatave të ADR-it për persona për manipulim me lëndë djegëse dhe të rrezikshme,
- 2.15 Dhënia e lejes së autoboteve për sasinë e lëndës djegëse e cila bartet,
- 2.16 Aftësimin e drejtuesve të automjeteve transportuese për materie djegëse dhe materie të rrezikshme,
- 2.17 Kontrollimi teknik për transport të lëndëve djegëse dhe të rrezikshme,
- 2.18 Trajnimin e personelit për inspektimin e automjeteve motorike,
- 2.19 Atestimi i konstruksioneve të salduara dhe enëve nën presion,

- 2.20 Ofrimi i konsultimeve profesionale,
- 2.21 Hulumtimet laboratorike me metodën e shkatërrimit dhe pa shkatërrim,
- 2.22 Aftësimi dhe certifikimi i saldatoreve sipas EU normave,
- 2.23 Aftësimi dhe certifikimi i manipulueseve me makina të renda
- 2.24 Aftësimi dhe certifikimi i manipulueseve me pirunjerë, vinça, dhe pajisjeve ngritëse,
- 2.25 Veprimtaritë nga lëmia e Komunikacionit si:
 - a) kryerjen e super ekspertizave gjygjësore, me rastin e fatkeqësive në komunikacionin rrugor,
 - b) vlerësimin e dëmeve të shkaktuara në automjete, si rezultat i ndeshjeve në komunikacion,
 - c) kryerjen e studimeve për komunikacionin rrugor dhe sinjalistikën rrugore, me qëllim të rritjes së shkalles së sigurisë në rrugë, rritjen e kapacitetit dhe përmirësimin e nivelit të shërbimit,
 - d) projektimin dhe rregullimin e qarkullimit përmes sinjalizimit horizontal, vertikal dhe ndriçues në qendra urbane dhe ndërurbane,
 - e) projektimin e linjave në transportin urban të udhëtarëve dhe përpilimin e orarit të udhëtimeve, kryerjen e studimeve për planifikim afatshkurtër dhe afatgjatë në transportin urban dhe ndërurban, dhe
 - f) mbikëqyrjen e projekteve, realizimeve dhe pranimeve teknike nga fusha e komunikacionit rrugor,
 - g) seminare, kurse, trajnime dhe licencime të ndryshme nga lëmia e komunikacionit rrugor, etj.
 - h) kryerjen e studimeve për organizimin e transportit integral dhe multimodal.
- 2.26 Matjet e shpejtësisë, temperaturës, lagështisë, zhurmës në pajisjet për ngrohje, ventilim dhe klimatizim,
- 2.27 Kontrollime teknike (nga aspekti i mbrojtjes në punë të makinave, të pajisjeve, të objekteve), kontrollin e litarëve ose konstruksioneve metalike me metodën me dhe pa shkatërrim,
- 2.28 Hartimin e elaborate investive, projekteve ideore, projekte kryesore (ekzekutuese) dhe projekte të gjendjes së kryer;
- 2.29 Korrigjimin (revidimin) e projekteve të punuara në ndërmarrjet e tjera të projektimit; projektimin e vijave të reja teknologjike; projektimin dhe zgjerimin e kapaciteteve ekzistuese; mënjanimin e “fytit” të ngushtë të prodhimit; mekanizmin dhe automatizimin e linjave ekzistuese,
- 2.30 Pranimin teknik të objekteve, të makinave ose të pajisjeve të reja,
- 2.31 Hulumtime të ndryshme lidhur me shkaqet e dëmtimeve të ndryshme,
- 2.32 Ekspertiza të ndryshme të prishjeve, të shkatërrimeve dhe të dëmtimeve me ose pa qëllim;
- 2.33 Udhëheqje dhe mbikëqyrje të investimeve dhe punë të ndryshme teknike, dhe
- 2.34 Këshillime dhe njohjen me rregullat, metodat dhe mënyrën e transportit të materialeve të rrezikshme në situata konkrete në praktike.

Neni 3

Pos veprimtarisë të cekur në Nenin 2, punëtorët e Institutit të Inxhinierisë Mekanike mund të merren edhe me veprimtari të tjera për të cilat paraqiten nevoja në Ekonomi dhe Industri të Kosovës por duke u mbuluar me kuadër adekuat profesional.

Neni 4

Në mungesë të pajisjeve të veçanta për kryerjen e shërbimeve të cekura, me leje të Rektorit të UP-së, Instituti mund të nënshkruaj kontratë me subjektet tjera, si të vendit ashtu edhe jashtë vendit për realizimin e punëve të caktuara në kontratë.

Neni 5

Subjekti me të cilin nënshkruhet kontrata për kryerjen e punëve të caktuara duhet të sigurojë:

- a) Hapësirën e nevojshme të punës,
- b) Standardet relevante që kanë të bëjnë me aktivitetet e sipër përmendura.

Neni 6

1. Pas arritjes së marrëveshjes për kontraktimin e punëve, Rektori, në bazë të të dhënave për marrëveshjen e arritur për kontraktimin e punëve, nënshkruan kontratën, e cila duhet të përmbajë:

- a) Të gjitha elementet e marrëveshjes së arritur,
- b) Përcaktimin preciz të punëve dhe detyrave të punës,
- c) Vlera precize të kontraktuar për secilin pozicion,
- d) Vlera e tërësishme e punës,
- e) Afati i kryerjes së punimeve, dhe
- f) Mënyra e pagesës.

2. Para se të lidhet kontrata nga pika paraprake, drejtuesi i Institutit (Dekani i FIM-it) e cakton bartësin e punëve dhe kryesit tjerë të punëve duke marrë si kriter themelor: mendimin e kontaktuesit të punëve, kompetencat profesionale dhe shkencore të kryesve të punimeve, si dhe mendimin e porositësit të punëve.

3. Nëse vlerësohet se, vlera e punëve të kontraktuara është e lartë, në atë punë behët kyçja e një numri me të madh të personelit adekuat, i cili në momentin e caktuar është i angazhuar ose me pak i angazhuar.

Neni 7

Pagesa e punëve të kontraktuara behët në llogarinë bankare të Institutit të Inxhinierisë Mekanike përkatësit të Universitetit të Prishtinës "HASAN PRISHTINA".

Neni 8

Ndarja e mjeteve të realizuara dhe pagesa për punën e kryer

1. Pagesa e punëve të kryera behet sipas rregulloreve përkatëse të UP.
2. Ndarja e mjeteve financiare të realizuara në bazë të punëve në specifikim do të bëhet në bazë të rregulloreve të Këshillit Drejtues të UP.
3. Shpenzimet direkte të krijuara gjatë punëve (shpenzimet e udhëtimit, shpenzimet për blerjen e pajisjeve të nevojshme për realizimin e punëve, materiali hargjues, etj.) lejohen të jenë në lartësi maksimale 10% nga vlera e kontraktuar.
4. Ndarja e mjeteve financiare të realizuara nga projektet apo shërbimet në bazë të punëve të kryera bëhet si vijon:

Mjetet bruto të realizuara..... A (100%)

Për buxhetin e Universitetit..... B = 23 % A

Mbetja C=A-B

Shpenzimet direkte (10%)SHD = 10% C

D=C-SHD

Për personelin e rektoratit..... PR = 10% D

Për buxhetin e Fakultetit

a) Nëse shërbimet kryhen pa laborator F¹=10% D

b) Nëse shërbimet kryhen me laborator F²=20% D

Personelit të angazhuar të fakultetit versioni a).....PA=D-(R+F¹)

Personelit të angazhuar të fakultetit versioni b)..... PA=D-(R+F²)

5. Të gjitha ndryshimet e sipërshënuara janë pjesë përbërëse të Rregullores nr. 2/513 të datës 25.10.2013.

Neni 9

Mjetet 10% përkatësisht 20% për Fakultetin, konform Rregullores 2/513 të KD/UP mund të ndahen: deri 50% për stafin mbështetës administrativ për punë mbështetëse (plotësuese) ndaj Institutit, punë plotësuese ndaj Institutit nga stafi akademik dhe mbështetje të projekteve të studentëve.

Neni 10


Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje, shfuqizohet Rregullorja e punës Nr. 1/821 e datës 29.06.2010.

Neni 11

Kjo Rregullore është harmonizuar me rregulloren Nr. 2/513 të datës 25.10.2013 të Këshillit Drejtues të Universitetit të Prishtinës "HASAN PRISHTINA".

Kjo Rregullore hyn në fuqi në ditën e aprovimit dhe nënshkrimit të saj nga kryetari Këshillit Drejtues të UP-së.

Kryetari i Këshillit Drejtues të UP-së



Prof. Dr. Ismet Salihu

